



#### INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

#### PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbetëria e Bashkuar

#### VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

#### KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)  
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1  
10 000 Prishtina, Kosovo  
Tel: +383 (0)38 542 778  
Web-site: [www.kipred.org](http://www.kipred.org)  
Email: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org)

# LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

**MEDIAT RUSE**

SHTATOR 2020

## HYRJE

**Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse** synon t'u kundërvihet dezinformatave që e kanë në shënjestër Kosovën, përmes monitorimit në bazë mujore të botimeve të përzgjedhura mediale që dalin në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, ndërkaq, në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën i monitoron edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të lëshuara nga Kremli dhe Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë shtatorit 2020, Russia Insider i ka botuar 2 lajme, TASS-i 7, The Duran 3, Newsfronti 9, Unzi 3, The Moscow Times 4, Russia Today 9, Sputnik International 14, ndërsa Sputnik Serbia i ka botuar 217 lajme që kishin të bënin drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me Kosovën. Ndërkaq, Meduza dhe Pravda Report nuk e kanë botuar asnjë lajm që kishte të bënte me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, në ueb-sajtet e tyre, Kremli e kishte 1, dhe Ministria e Jashtme Ruse 2 postime që kishin të bënin me Kosovën.

Për shkak të numrit të madh të artikujve me përmbajtje dezinformuese të lëshuara nga këto media, ky botim i analizon vetëm artikujt me përmbajtjen dezinformuese më flagrante. Dezinformatat e botuara synonin t'ia gërmonin themelet shtetësisë së Kosovës, si dhe ta diskreditonin kredibilitetin e politikës së SHBA-ve. Në këtë, këto media i mohonin krimet e luftës të kryera nga Serbia në Kosovë, e akuzonin SHBA-në dhe NATO-n për krimet e luftës kundër popullatës serbe, e rritnin numrin e viktimave serbe, dhe, nga ana tjetër, politikanët serbë i akuzonin institucionet e Kosovës për shkeljen dhe sabotimin e marrëveshjeve të arritura në Washington dhe në Bruksel.

# DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

## Lajmërim i Dezinformatës 1

**Titulli:** Вучић: Одбраном територијалног интегритета Србија брани темеље УН [Vuçiqi: Me mbrojtjen e integritetit të vet territorial, Serbia është duke i mbrojtur themelet e KB], **Sputnik Serbia, 21 shtator 2020.**<sup>1</sup>

Me rastin e 75 vjetorit të KB, Presidenti serb Aleksandar Vuçiq tentoi që veten ta paraqiste si mbrojtës dhe promovues të vlerave të KB. Ndër të tjera, Vuçiq pretendon se “Institucionet e Përkohshme në Prishtinë e shpallën pavarësinë si një veprim i njëanshëm, dhe e shkelën Rezolutën 1244 të KB, duke e minuar kështu në mënyrë serioze sigurinë e Serbisë dhe të rajonit si të tërë.” Ai më pas shton se “Me mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të vet territorial, dhe duke e respektuar Rezolutën 1244, Serbia po ashtu e mbron të drejtën ndërkombëtare, Kartën e KB, por, po ashtu, përfundimisht, edhe autoritetin e Këshillit të Sigurisë.”

## **Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra**

Këto deklaratatë të Vuçiqit i përmbajnë dy elemente të dezinformatës. Së pari, ai përpiqet që autorët e deklaratës së pavarësisë t’i paraqesë si “institucione të përkohshme,” dhe, nga ana tjetër, ai thekson se “deklaratatë e pavarësisë e shkel RKSKB 1244.”

Me 17 shkurt 2008 Kosova e shpalli pavarësinë duke u mbështetur në Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.<sup>2</sup> Serbia, e përkrahur nga Rusia, e parashtroi kërkesën për mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), me pyetjen: “A është

---

<sup>1</sup> Вучић: Одбраном територијалног интегритета Србија брани темеље УН [Vuçiqi: Me mbrojtjen e integritetit të vet territorial, Serbia është duke i mbrojtur themelet e KB], <https://rs.sputniknews.com/politika/202009211123438785-vucic-odbranom-teritorijalnog-integriteta-srbija-brani-temelje-un/>.

<sup>2</sup> Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement [Marrëveshja Gjithpërfshirëse për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës], [https://web.archive.org/web/20091015082628/http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](https://web.archive.org/web/20091015082628/http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf)

shpallja e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?”. Gjykata përfundoi që autorët e deklaratës së pavarësisë më 17 shkurt 2008 nuk kanë vepruar në cilësinë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në kuadrin e Kornizës Kushtetuese, por më parë si persona që vepruan së bashku në cilësinë e përfaqësuesve të popullit të Kosovës, jashta kornizës së administrimit të përkohshëm.<sup>3</sup> Prandaj, meqenëse deklarata e pavarësisë nuk është lëshuar nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, ajo, rrjedhimisht, nuk e ka shkelur Kornizën Kushtetuese. Në lidhje me këtë, duhet të vërehet se opinioni i GJND-së konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk e ka shkelur Rezolutën 1244 të KSKB, dhe as ndonjërin nga normat legale ndërkombëtare.<sup>4</sup>

Kështu, ndërkohë që veten e paraqet si promovues të vlerave të KB-ve, Vuçiqi, nga ana tjetër, është duke dhenë deklarata që janë të kundërta me opinionin këshillues të GJND-së, e cila është trupi kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara.<sup>5</sup>

## **Lajmërim i Dezinformatës 2**

**Titulli:** Дачић: Показао сам Гренелу писмо које доказује да је Приштина већ срушила споразум [Даџиќ: Grenellit ia tregova letrën që dëshmon se Prishtina tashmë e ka shkelur marrëveshjen], **Sputnik Serbia, 25 shtator 2020.**<sup>6</sup>

Ivica Daçiqi pohon rrejtshëm se kërkesa që Ministrja e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Meliza Haradinaj–Stublla ia ka bërë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bosnjes e Hercegovinës, është një veprim që e shkel marrëveshjen e Washingtonit. Ai thekson se kërkesa

---

<sup>3</sup> International Court of Justice [Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë]. Advisory Opinion on the accordance with international law of the unilateral declaration of independence of Kosovo [Opinion Këshillues për pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës], 22 korrik 2010, <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> International Court of Justice [Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë], <https://www.icj-cij.org/en>.

<sup>6</sup> Дачић: Показао сам Гренелу писмо које доказује да је Приштина већ срушила споразум [Даџиќ: Grenellit ia tregova letrën që dëshmon se Prishtina tashmë e ka shkelur marrëveshjen], <https://rs.sputniknews.com/politika/202009251123458520-dacic-pokazao-sam-grenelu-pismo/>.

për njohje nga Republika e Kosovës është e ndaluar me marrëveshjen e Washingtonit. Ai shton se “Grenellit ia kam treguar letrën që dëshmon se Prishtina tashmë e ka shkëlur marrëveshjen.” Për më tepër, ai thekson se “Prishtina nuk e ka fare problem që tash të nënshkruaj çfarëdo qoftë, dhe që atë të mos e zbatojë më vonë, dhe konfirmim i kësaj është, ashtu siç Daçiqi vë në dukje, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe në Kosovë. Nga ana tjetër, ai e akuzon Bashkimin Evropian lidhur me Asociacionin, duke theksuar se “nuk ka reagim nga Brukseli, dhe ata janë garantues të asaj marrëveshjeje, e cila është nënshkruar shtatë vite më parë, dhe është nënshkruar nga Hashim Thaçi, Catherine Ashton dhe unë.”

## **Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra**

### **a) Marrëveshja e Washingtonit**

Marrëveshja e Washingtonit u nënshkrua me 4 shtator 2020, në Zyren Ovale, midis Kosovës dhe SHBA-ve, nga njëra anë, dhe Serbisë dhe SHBA-ve, nga tjetra.<sup>7</sup> Marrëveshja është e një natyre ekonomike, por po ashtu përmban disa pika lidhur me aplikimin në organizatat ndërkombëtare, njohjen e Kosovës, fushatën e çnjohjeve të Serbisë, njohjen nga Izraeli, etj.<sup>8</sup> Ivica Daçiqi aludon gabimisht në pikën e marrëveshjes që pohon qartë se “Kosova do të pajtohet që ta zbatojë një moratorium njëvjeçar në përpjekjet për anëtarësi të reja në organizatat ndërkombëtare. Serbia do të pajtohet me një moratorium njëvjeçar të fushatës së saj të çnjohjeve, dhe do të përmbahet nga kërkesat formale ose joformale ndaj çdo kombi apo organizate ndërkombëtare që të mos e njohin Kosovën si shtet të pavarur.”<sup>9</sup> Prandaj, Kosova e ka pranuar një moratorium njëvjeçar nga aspekti i anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare, por duhet të vërehet që është Serbia ajo që duhet të heq dorë nga kërkesat që u bën vendeve apo organizatave ndërkombëtare për të mos e njohur Kosovën si shtet të pavarur, dhe jo Kosova. Dhe, kjo është pikërisht e kundërta e asaj që Daçiqi deklaron. Për më tepër, ky fakt konfirmohet, po ashtu, përmes pikës së fundit të

---

<sup>7</sup> Serbia, Kosovo normalize economic ties, gesture to Israel [Serbia, Kosova, i normalizojnë lidhjet ekonomike, dhe e bëjnë një gjest për efekt ndaj Izraelit], [https://www.washingtonpost.com/politics/kosovo-serbia-normalize-economic-ties-gesture-to-israel/2020/09/04/f803b83c-eec5-11ea-bd08-1b10132b458f\\_story.html](https://www.washingtonpost.com/politics/kosovo-serbia-normalize-economic-ties-gesture-to-israel/2020/09/04/f803b83c-eec5-11ea-bd08-1b10132b458f_story.html).

<sup>8</sup> Washington-Agreement-Kosovo-Serbia [Marrëveshja e Washingtonit Kosovë-Serbi], <https://www.new-perspektiva.com/wp-content/uploads/2020/09/Washington-Agreement-Kosova-Serbia.pdf>.

<sup>9</sup> Ibid.

marrëveshjes, e cila e garanton njohjen e Kosovës si shtet i pavarur nga Izraeli.<sup>10</sup> Është evidente se deklarata e Daçiqit është një shembull klasik i keqinterpretimit dhe manipulimit politik, që nuk përkon me fjalët e përdorura në Marrëveshjen e Washingtonit.

## **b) Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe**

Autoritetet e Beogradit dhe të Moskës janë ankuar në mënyrë të përsëritur se institucionet e Kosovës janë duke sabotuar dhe bllokuar jetësimin e marrëveshjes së Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Në vitin 2015, Kosova dhe Serbia e kanë arritur marrëveshjen për parimet e përgjithshme të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë.<sup>11</sup> Marrëveshja përcaktonte që Bashkësia/Asociacioni do të jetë një entitet legal i përkufizuar nga statuti.<sup>12</sup> Për më tepër, draftimi i statutit ishte detyrë e Ekipit Menaxhues, me ndihmën, po të jetë nevoja, të Ministrisë së Qeverisjes Lokale.<sup>13</sup> Lidhur me këtë, duhet theksuar se Ekipi Menaxhues përbëhej nga katër zyrtarë serbë,<sup>14</sup> që e kishin për detyrë ta draftonin statutin, dhe nuk dihet nëse ata e kanë kryer këtë detyrë të tyre deri më tash.<sup>15</sup>

Për më tepër, në vitin 2015, kur marrëveshja u arrit, Ministri i Ministrisë së Qeverisjes Lokale ishte nga Lista Serbe, dhe Ministria, madje edhe sot, udhëhiqet nga kryesuesi nga Lista Serbe.<sup>16</sup> Prandaj, përgjegjësia për vonesën e jetësimin të Asociacionit/Bashkësisë është te Ekipi Menaxhues dhe ministrat serbë. Për më tepër, në fund, Daçiqi, jo vetëm që e akuzon Kosovën

---

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Serbia and Kosovo Reach Four Key Agreements [Serbia dhe Kosova i arrijnë katër marrëveshje kyçe], <https://balkaninsight.com/2015/08/26/serbia-kosovo-reach-four-key-agreements-08-26-2015/>.

<sup>12</sup> Association/Community of Serb majority municipalities in Kosovo – general principles/main elements, Article 2 [Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – parimet e përgjithshme/elementet kryesore, Neni 2], [https://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](https://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf)

<sup>13</sup> Ibid, Neni 21.

<sup>14</sup> Koha.net: Çka thuhet në procesverbalet e ekipit menaxhues për Asociacionin?

<https://www.koha.net/arberi/111137/cka-thuhet-ne-procesverbalet-e-ekipit-menaxhues-per-asociacionin/>

<sup>15</sup> Radio Evropa e Lirë, Draft-statuti i Asociacionit nuk i është dorëzuar as Prishtinës dhe as BE-së,

<https://www.evropaelire.org/a/draft-statuti-i-asociacionit-nuk-i-eshte-dorezuar-as-prishtines-dhe-as-be-/29568500.html>

<sup>16</sup> MINISTRIA E Qeverisjes LOKALE, GORAN RAKIĆ, Ministër, Ministria e Administrimit të Qeverisjes Lokale, <https://mapl.rks-gov.net/en/organizimi-en/ministri-dhe-kabineti-i-ministrit-en/>.

për sabotimin e marrëveshjes, por ai, po ashtu, e akuzon edhe Bashkimin Evropian dhe Miroslav Lajčakun.

### **Lajmërim i Dezinformatës 3**

**Titulli:** Америка на корак од заокрета: Признаје ли Трамп да је стварање независног Косова — грешка [Америка një hap para kthimit: A është duke e pranuar Trumpi që krijimi i Kosovës së pavarur është – gabim], **Sputnik Serbia, 15 shtator 2020.**<sup>17</sup>

Artikulli e diskuton politikën e SHBA-ve, duke pohuar rrejtshëm se ajo e ka ndryshuar qëndrimin e saj për çështjen e Kosovës. Për më tepër, artikulli jep informata të pasakta për trazirat e marsit 2004 në Kosovë. Artikulli pohon se “Për herë të parë Amerika në parim e ka të njëjtin qëndrim me Serbinë”; “Ishte gabim që pas bombardimit të vitit 1999 të Serbisë, Amerika nuk lejoi që të respektoheshin fjala dhe fryma e Rezolutës 1244, dhe integriteti territorial i Serbisë (në atë kohë, Serbia dhe Mali i Zi)”; “Trumpi mendon se është në tërësi gabim që Amerika i lejoi shqiptarët t’i dëbonin më shumë se 4,000 serbë më 17 mars 2004, që t’i vrisnin me dhjetra njerëz, t’i shkatërronin rreth 1,000 shtëpi, dhe t’i digjin dhe shkatërronin rreth njëqind objekte të shenjta në Kosovë e Metohi.”

### **Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra**

Ky artikull është në tërësi manipulativ, dhe përmban elemente të shumta të dezinformatës. Ky, së pari, fillon me një interpretim të politikës amerikane, duke paraqitur që Donald Trumpi mendon se çdo gjë që ka ndodhur në Kosovë ka qenë gabim, si dhe në çështjet me të cilat ai është duke u marrë, dhe ky po ashtu jep informata në tërësi të pavërteta.

---

<sup>17</sup> Америка на корак од заокрета: Признаје ли Трамп да је стварање независног Косова — грешка [Америка një hap para kthesës: A është duke e pranuar Trumpi që krijimi i Kosovës së pavarur është – gabim], <https://rs.sputniknews.com/am/autori/202009151123399335-amerika-na-korak-od-zaokreta-priznaje-li-tramp-da-je-stvaranje-nezavisnog-kosova--greska/>.

### **a) Politika e SHBA-ve ndaj Kosovës nën administratën e Donald Trumpit**

Para së gjithash, duhet të vërehet se Shtetet e Bashkuara kanë qenë dhe mbeten aleati kryesor i Republikës së Kosovës. Gjatë administratës së Donald Trumpit është arritur një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë, e cila Kosovën e trajton si palë të barabartë me Serbinë, dhe që Kosovën e respekton si një shtet të pavarur. Për më tepër, përmes kësaj marrëveshjeje, Republika e Kosovës e ka siguruar njërën nga njohjet më të rëndësishme, njohjen nga Izraeli. Dhe fakti i fundit që e dëshmon rëndësinë e SHBA-ve për Kosovën, është themelimi i Ushtrisë së Kosovës,<sup>18</sup> i cili ka ndodhur pikërisht gjatë mandatit të Trumpit, dhe me përkrahjen e administratës së tij.<sup>19</sup> Moska dhe Beogradi e kanë kundërshtuar në mënyrë të qëndrueshme themelimin e Ushtrisë së Kosovës, duke pohuar se ajo paraqet kërcënim për sigurinë e rajonit.

### **b) Trazirat e Marsit 2004**

Sipas Raportit të Human Rights Watch, “Failure to Protect” [Dështimi për të Mbrojtur], dhuna e marsit 2004 i la 19 persona të vrarë (11 shqiptarë dhe 8 serbë), ndërsa 954 ishin plagosur. Raporti po ashtu thotë se pos serbëve, janë goditur edhe pakicat e tjera jo-shqiptare, si romët, ashkalitë, dhe të tjera. Pos kësaj, sipas raportit “të paktën 550 shtëpi dhe njëzet e shtatë kisha dhe manastire ortodokse janë djegur,”<sup>20</sup> e që është më pak se 1000 shtëpi dhe 100 objekte të shenjta, të cilat i pohon artikulli. Është po ashtu e rëndësishme të përmendet se artikulli gabimisht dhe me qëllim e shfrytëzon shprehjen “pogrom” [masakër], edhe pse të gjitha organizatat relevante ndërkombëtare ngjarjeve të marsit 2004 u janë referuar si “trazira.”<sup>21</sup>

---

<sup>18</sup> Kosovo approves new army despite Serb opposition, NATO criticism [Kosova e miraton ushtrinë e re edhe përkundëjt kundërshtimit serb, kritikave të NATO-s], <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-army-idUSKBN1OD16S>.

<sup>19</sup> US backs Kosovo's plan to create an army [SHBA-të e përkrahin planin e Kosovës për ta krijuar ushtrinë], <https://www.france24.com/en/20181206-us-backs-kosovos-plan-create-army>.

<sup>20</sup> “Failure to Protect, [Dështimi për të Mbrojtur]” Raport i Human Rights Watch, korrik 2004, <https://www.hrw.org/report/2004/07/25/failureprotect/anti-minority-violence-kosovo-march-2004>.

<sup>21</sup> Organizatat ndërkombëtare të tilla si UNMIK-u, OSCE-ja dhe Human Rights Watch. Shih për shembull raportin e HRW “Failure to Protect’ [Dështimi për të mbrojtur]; shih po ashtu edhe punimin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë “Four Years Later: Follow up of March 2004 Riots Cases before the Kosovo Criminal Justice



#### **Lajmërim i Dezinformatës 4**

**Titulli:** Да ли је Трамп схватио грешке Америке у косовском конфликту?, [А и ка кuptuar Trumpi gabimet e Amerikës në konfliktin e Kosovës?], **Sputnik Serbia, 15 shtator 2020.**<sup>22</sup>

Artikulli e nënvizon opinionin e analistit politik Dragomir Angjellkoviq, që flet për politikën e SHBA-ve dhe për qasjen e Donald Trumpit ndaj çështjes së Kosovës. Ndër të tjera, Angjellkoviq thekson se “Është e qartë se gabimi më i madh i Amerikës është me siguri se ajo e bëri një agresion ndaj një shteti sovran, me qëllim që ta okupojë një pjesë të territorit të saj”; “Kur ai foli për keqmenaxhimin e konfliktit, ai me gjasë ka menduar në agresionin kundër RFJ-së, i cili ka ndodhur 20 vite më parë.”

#### **Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra**

Ngjashëm me artikullin paraprak, edhe ky artikull bën pohime që përpiqen t’i nënvizojnë ndryshimet në politikën e SHBA-ve ndaj Kosovës, duke theksuar që Donald Trumpi ‘agresionin’ ndaj Serbisë e sheh si të gabuar, duke aluduar në intervenimin e NATO-s, qëllimi i të cilit kinse ishte okupimi i një pjese të territorit të Serbisë. Lajme të ngjashme u botuan në 2016, në gazetën serbe Nedeljnik, që pohonte se “Donald Trumpi kërkoi falje për rolin e SHBA-ve në bombardimin e ish-Jugosllavisë në vitin 1999.”<sup>23</sup> Raportet e tilla u demantuan nga Jason Miller, këshilltar i Donald Trumpit, i cili pohoi që “Z. Trump asnjëherë nuk i ka dhënë intervistë revistës javore serbe Nedeljnik, ashtu siç është raportuar rrejtshëm nga Newsweeku i diskredituar”; “Ky ishte një rreng,

---

System” [Katër vite më vonë: Rezume e rasteve të Trazirave të Marsit 2004 para Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë], Departamenti i Monitorimit, Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor, qershor 2008.

<sup>22</sup> Да ли је Трамп схватио грешке Америке у косовском конфликту? [А и ка кuptuar Trumpi gabimet e Amerikës në konfliktin e Kosovës?], <https://rs.sputniknews.com/analize/202009151123399511-da-li-je-tramp-shvatio-greske-amerike-u-kosovskom-konfliktu/>

<sup>23</sup> Serbian Magazine Retracts Article Saying Trump Apologized For NATO Bombing [Revista serbe e tërheq artikullin që thotë se Trumpi ka kërkuar falje për bombardimin e NATO-s], <https://www.rferl.org/a/us-serbia-trump-apologizes-1999-nato-bombing/28051438.html>.

dhe presim që ta marrim një tërheqje dhe kërkesë formale të faljes nga të gjithë që ishin të përfshirë.”<sup>24</sup>

Lidhur me ‘okupimin’ e territorit të Serbisë si rezultat i intervenimit të NATO-s, duhet theksuar se prania ushtarake në Kosovë është vendosur nga Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurisë së KB, e cila autorizoi themelimin e pranisë ushtarake ndërkombëtare dhe të pranisë civile ndërkombëtare në Kosovë.<sup>25</sup> Duhet të qartësohet se intervenimi i NATO-s në vitin 1999 kundër RFJ-së ishte vetëm një fushatë ajrore, dhe ky asnjëherë nuk përfshiu trupa tokësore. Mirëpo, trupat e NATO-s kanë hyrë në Kosovë (e cila zyrtarisht ishte territor i RFJ-së) në qershor 1999, pas nënshkrimit të “Marrëveshjes Ushtarake Teknike” në Kumanovë midis NATO-s dhe autoriteteve të Beogradit.<sup>26</sup>

### **Lajmërim i Dezinformatës 5**

**Titulli:** Remembering NATO's Ruthless Bombing Campaign in Serbia [Duke kujtuar fushatën mizore të bombardimit në Serbi], **Russia Insider, 18 shtator 2020.**<sup>27</sup>

Ky artikull është ribotim nga viti 2015, nga Russia Insider. Ndër të tjera, artikulli bën pohime të rrejshme për masakrën e Reçakut. Merret se akuzat mund të kenë qenë false, dhe se trupat në fakt i kanë takuar kryengritësve të UÇK-së, teshat e të cilëve janë ndërruar. Lidhur me bombardimet e NATO-s, artikulli pohon se “2,000 civilë janë vrarë, përfshirë 88 fëmijë, dhe mijëra të tjerë janë plagosur.” Dhe, së fundi, artikulli pohon se “Mbi 200,000 serbë etnikë u detyruan ta braktisnin atdheun e tyre, Kosovën.”

---

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> United Nations, Security Council, Resolution 1244 (1999) [Kombet e Bashkuara, Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurisë], [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old\\_dnn/Res1244ENG.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/Res1244ENG.pdf).

<sup>26</sup> “Marrëveshja Ushtarake Teknike Midis Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë,” Kumanovë, 9 qershor 1999, <https://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>.

<sup>27</sup> Remembering NATO's Ruthless Bombing Campaign in Serbia [Duke kujtuar fushatën mizore bombarduese të NATO-s në Serbi], <https://russia-insider.com/en/history/remembering-natos-ruthless-bombing-campaign-serbia/ri4853>.

## Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

### a) Masakra e Reçakut

Në një përpjekje për t'i mohuar krimet e luftës të kryera nga forcat e armatosura serbe në Kosovë, ky artikull tenton t'i paraqesë viktimat e masakrës së Reçakut si anëtarë të UÇK-së. Kreu i Ekipit Hetues Finlandez, Dr. Helena Ranta, e cila ishte në krye të hetimit të masakrës së Reçakut, pasi që hetimi përfundoi, tha se forenzika ka treguar se 45 viktimat ishin civilë të paarmatosur, duke e cilësuar aktin si “krim kundër njerëzimit.”<sup>28</sup> Lidhur me pohimet se teshat mund të jenë ndërruar, Kreu i Misionit të OSBE-së, Ambasadori William Walker, kishte pohuar gjatë një interviste se “Nuk ka kuptim të mendohet se njerëzit nëpër male, në mes të natës, në atë rrëpirë të akullit e të rrëshqitshme, ishin duke ndërruar tesha dhe duke i ngjyrosur njerëzit me gjak, dhe duke i vrarë; Unë këtë as që mund ta imagjinoj.”<sup>29</sup>

### b) Ekzagjerimi i numrit të paraqitur të viktimave

Raporti i Human Rights Watch “Civilian Deaths in the NATO Air Campaign” [“Vdekjet e civilëve në fushatën ajrore të NATO-s”], në bazë të dëshmive në dispozicion, ka përfunduar se si rezultat i bombardimit të NATO-s janë vrarë, jo më pak se 488, dhe jo më shumë se 527 civilë jugosllavë. Ky raport më tutje qartësoi se midis 278 dhe 317 të të vdekurve ishin në Kosovë, 201 civilë u vranë në Serbi, dhe tetë në Mal të Zi.<sup>30</sup>

Nga ana tjetër, të dhënat e hollësishme të mbledhura bazuar në 31,600 dokumente, të paraqitura në botimin “Libri i Kujtesës së Kosovës” (2 shkurt 2015), i cili u përgatit nga Qendra për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, konfirmon se sulmet e NATO-s e kanë vrarë një total prej 754 njerëzish – 454 civilë dhe 300 pjesëtarë të forcave të armatosura. 207 civilë ishin të etnisë serbe dhe malazeze, 219 ishin shqiptarë, 14 civilë të vrarë ishin romë, dhe 14 u takonin kombësive të

---

<sup>28</sup> Recak report finds Serbs guilty [Raporti i Reçakut gjen se fajtorë janë serbët], <https://www.theguardian.com/world/1999/mar/18/4>.

<sup>29</sup> Intervista Frontline, Ambasadori William Walker, <https://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/interviews/walker.html>.

<sup>30</sup> “Civilian Deaths in the NATO Air Campaign [Vdekjet e civilëve në fushatën ajrore të NATO-s],” Raport i Human Rights Watch, Vëllimi 12, Numër 1 (D), 2000, <https://www.hrw.org/reports/2000/nato/>.

tjera. E qartë, të dhënat e dokumentuara tregojnë se numri i vdekjeve gjatë fushatës ajrore të NATO-s ishte shumë më i ulët se 2,000, ashtu siç e thotë artikulli.

**c) Manipulimi i numrit të refugjatëve serbë të Kosovës të pasluftës**

Sipas raportit të botuar nga Qendra Koordinuese për Kosovën e Qeverisë së Serbisë në shkurt 2002, në Kosovë kanë qenë duke jetuar 129,474 serbë. Nga ana tjetër, sipas regjistrimit të fundit jugosllav të vitit 1991, në Kosovë ishin duke jetuar 194,000 serbë, me gjasa tejet të vogla që ka patur ndonjë trend për rritjen e këtij numri gjatë viteve 1990. Këto shifra e projektojnë një numër prej më së shumti 75,000 serbëve që e kanë braktisur Kosovën pas luftës, e i cili numër është shumë më i vogël se numri 200,000, të cilin e përmend artikulli.